

**STATUTI**  
**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“AL KOS Pharma” SH.P.K.**

Tiranë, dt. 22.10.2020

**I.THEMELIMI**

**Neni 1**

**Ortaku themelues**

1.1 Shoqëria me përgjegjësi te kufizuar e quajtur “AL KOS Pharma” Sh.P.K. themelohet nga ortaku themelues:

1. **Z. Jetmir Xharavina** shtetas Kosovar, lindur në Gjakovë, më 17/11/1995, mbajtës i kartës së identitetit nr. ID0004493 lëshuar në Gjakovë, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar;

**II. EMERTIMI – SELIA-FORMA JURIDIKE-OBJEKTI**

**Neni 2**

**Emërtimi**

2.1 Shoqëria emërtohet “AL KOS Pharma” Sh.P.K

**Neni 3**

**Forma ligjore**

3.1 Shoqëria do të jetë me përgjegjësi te kufizuar (SHPK) sipas Ligjit Shqiptar

3.2 Shoqëria mund të transformohet në një formë tjetër juridike nëse vendoset nga Asambleja e ortakeve në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 4**

**Personaliteti Juridik**

4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me nenet e statutit, Ligjit nr.99021, datë 14.04.2008, “ Për shoqëritë tregtare” si dhe me legjislacionin shqiptar

**Neni 5**

**Selia e shoqërisë**

5.1 Selia e shoqërisë është në adresën: **Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 2, Rruga “Hoxhë Vokrri”, Nr. 706, 1001.**

5.2 Shoqëria mund të çelë filiale apo zyrë përfaqësie në qytete të tjera të republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.



**Neni 6**  
**Emblema/Vula**

6.1 Shoqëria ka vulën e saj.

6.2 Forma e vulës dhe masa e saj do të përcaktohen nga Asambleja e ortakeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 7**  
**Objekti i shoqërisë**

7.1 Shoqëria ka objekt veprimtarie si më poshtë:

- Hartimi, projektimi, zbatimi i fushatave të publicitetit në formë të ndryshme të komunikimit publik dhe në mjetet e informatikës publike si gazeta, revista, radio.
- Supervizime dhe konsulencë në fushë të ndryshme në aspektin e menaxhimit.
- Prodhimi dhe ndërtimi i materialeve të ndryshme që shërbejnë për aktivitetin e shoqërisë si dhe të gjitha llojeve, import-eksport të materialeve të gatshme dhe gjysem të gatshme që shërbejnë për mbarevajtjen e aktivitetit të shoqërisë.
- Tregtim me shumicë dhe pakicë të materialeve që shërbejnë në funksion të veprimtarisë së shoqërisë.
- Import – eksport i produkteve ushqimore me origjinë shtazore dhe bimore (për njëzë), si dhe suplementeve dietale.
- Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet, shtohet apo kufizohet në bazë të vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

**III.KOHEZGJATJA – KAPITALI I SHOQËRISE**

**Neni 8**  
**Kohëzgjatja**

8.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes së mëparshme të saj sipas Vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

8.2 Shoqëria ka personalitet juridik duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**Neni 9**  
**Kapitali i Shoqërisë**

9.1 Kapitali i shoqërisë është 10.000 ALL dhe përbehet nga 1 kuotë. Kapitali i shoqërisë është nënshkruar dhe derdhur nga ortaku i vetëm:

-Z. **Jetmir Xharavina**, zotëron 1 kuotë që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar me një vlerë prej 10.000 ALL



## **Neni 10** **Transferimi i kuotave**

10.1 Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakeve. Kuotat janë të transferueshme mes ortakeve por duhet të jene të ofruara sipas opsionit, ne përpjesëtim të drejtë me kuotat e zotëruara prej secilit nga ortaket e tjerë. Oferta e shitblerjes duhet të jetë e shkruar dhe një kopjo i dërgohet organit administrativ të shoqërisë.

10.2 Pjesët e kapitalit mund t'i transferohen të tretëve. Në këtë rast kanë të drejtën e parablerjes.

10.3 Ortakët qe synojnë të transferojnë pjesët e tyre të kapitalit pjesërisht ose plotësisht duhet t'ia komunikojnë ketë me letër të thjeshtë ortakeve të tjerë të kapitalit pjesërisht ose plotësisht duhet t'ia komunikojnë ketë me letër të thjeshtë ortakeve të tjerë të cilët kanë 1 ( një) javë kohë për të komunikuar vullnetin e tyre për të ushtrimin e të drejtës se parablerjes; mungesa e komunikimit brenda këtij afati do të konsiderohet si refuzim i të drejtës së parablerjes.

10.4 Ortaket mund t'u transferojnë të tretëve të gjithë ose pjese të pjesëve të kapitalit, vetëm pasi e drejta e parablerjes të jetë ushtruar ose refuzuar nga ortaket e Shoqërisë; transferimi i kuotave ne kundërshtim me sa parashikohet nga statuti nuk prodhon pasoja për Shoqërinë dhe nuk jep mundësinë për regjistrimin e blerësit ne librin e ortakeve.

10.5 Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme ne rruge trashëgimie.

## **Neni 11** **Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë**

11.1 Ortaket mund të zmadhojnë kapitalin e shoqërisë vetëm me vendim të Asamblesë se Ortakeve/Ortakut të vetëm të marra nga ortaket qe përfaqësojnë 3/4 të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

11.2 Vendimin për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë mund të risistemoje edhe numrin dhe vlerën e pjesëve të kapitalit.

11.3 Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë mund të realizohet dhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të reja të kapitalit nga ortakët qe hyjnë në shoqëri, të cilët do të pranohen si të tillë me vendim të ortakeve, ne të njëjtën mbledhje asambleje gjatë të cilës do të vendoset zmadhimi i kapitalit ne këtë mënyre.

11.4 Asambleja e ortakeve/ortaku i vetëm mund të vendosë kryerjen e financimeve nga ana e ortakëve por që nuk përbëjnë mbledhje kursimesh nga publiku në përputhje me ligjet fiskale dhe bankare. Shumat e derdhura mund të përdoren për mbulimin e humbjeve ose zmadhimin e kapitalit të shoqërisë apo për qëllime të tjera të parashikuara në objektin e veprimtarisë së shoqërisë. Ortakët mundet të kërkojnë të përcaktohet përdorimi dhe kohëzgjatja e financimit. Shuma që nuk përdoret për mbulimin e humbjeve duhet të zëvendësohet me mbarimin e afatit të financimit të përcaktuar në aktin e financimit.

## **Neni 12** **Zvogëlimi i kapitalit**

12.1 Zvogëlimi i kapitalit do te kryhet në përputhje me procedurat e parashikuara ne Ligjin "Per shoqëritë tregtare". Zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që zotërojnë.

12.2 Projekti i zvogëlimit i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar, të paktën 45 ditë përpara mbledhjes së asamblesë të thirrur për këtë arsye. Eksperti kontabël shqyrton projektin dhe ia paraqet ortakëve raportin e tij lidhur me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit.

12.3 Asambleja miraton raportin për zvogëlimin me 76 % te votave.



### **Neni 13** **Asambleja e Ortakëve**

13.1 Vendimet merren nga Asambleja e Ortakëve ose Ortaku i Vetëm.

13.2 Asambleja e Ortakëve ose Ortaku i Vetëm shqyrton dhe vendos për çështjet e mëparshme (por pa u kufizuar vetëm në këto ):

- Ndryshimi i selise ose hapja e zyrave të reja;
- Ndryshimi i emertimit të shoqërise;
- Zmadhimi dhe/ose zvogelimi i kapitalit të shoqërise;
- Blerja dhe/ose transferimi i kuotave të kapitalit të shoqërise tek të tjerët;
- Emertimi ose shkarkimi i administratorit/administratoreve;
- Prishja dhe likuidimi i shoqërise;
- Transformimi i shoqërise nga sh.p.k në një formë tjetër;
- Miratimi i bilancit të shoqërise.

### **Neni 14** **Asambleja e Zakonshme ose e Jashtëzakonshme**

14.1 Në Asambletë e Zakonshme, vendimet merren me votën në favor të mazhorancës së kapitalit të shoqërise. Komunikimi për thirrjen e Asamblese duhet të përmbajë datën, orën dhe vendin ku do zhvillohet Asambleja, qoftë për mbledhjen e parë ashtu dhe për mbledhjen e dytë. Mbledhja e dytë duhet të parashikohet të zhvillohet jo më pak se 3 (tre) ditë nga mbledhja e parë.

14.2 Në Asambletë kerkohet mazhorancë në masën prej  $\frac{3}{4}$  të votave, për përmbushjen e akteve të poshtshenuara:

- Modifikime të statutit;
- Zmadhimi dhe/ose zvogelimi i kapitalit të shoqërise;
- Blerja dhe/ose transferimi i kuotave të kapitalit të shoqërise tek të tjerët;
- Mbyllja e aktivitetit të shoqërise.

### **Neni 15** **Thirrja e Asamblesë**

15.1 Asambleja e ortakëve/ortakut të vetëm mund të thirret në çdo moment nga Administratori vetëm ose presidenti i Keshillit administrativ.

15.2 Mbledhjet do të zhvillohen në selinë e shoqërise, sipas njoftimit të administratorit ose të njërit nga administratorët.

15.3 Njoftimi do të jetë me shkrim, leter rekomandë, postë elektronike (e-mail) ose me ndonjë postë tjetër të regjistruar, të pakten 15 (pese mbledhjet) ditë përpara zhvillimit të mbledhjes dhe do të përmbajë orën, vendin dhe rendin e ditës.

15.4 Ortaket që përfaqësojnë pakicën dhe që nuk janë të pranishëm në mbledhje edhe pse të njoftuar rregullisht, pranojnë pa asnjë pretendim vendimet e marra nga shumica.

15.5 Ortaket e thirrur duhet të informohen për çështjet për të cilat do të vendoset. Ai që thërret Asambletë duhet të dorëzojë në selinë e shoqërise dokumentat e nevojshme për ortaket për të marrë vendimet dhe administratorët, me kërkesë të të interesuarve, duhet të sigurojnë nepërmjet postës ose mjeteve të tjera të ngjashme informacione, të adresuara në vendimin e treguar nga ortaku që ben kërkesën.

15.6 Ortaket mund të kërkojnë që data e asamblese të ndryshohet vetëm kur kanë arsye të justifikuara për këtë; gjithsesi kërkesa duhet të pranohet në rast se bëhet nga ortaket që përfaqësojnë të pakten 1/3 e pjesëve të kapitalit pevec nëse shtyrja e vendimeve që duhen marrë nuk vjen në kundërshtim me ligjin ose nuk i shkakton shoqërise dëme të rënda.



## **Neni 16 Vendimet**

16.1 Vendimet merren me votat e ortakeve te pranishem personalisht ose te përfaqesuar me prokure. Nje administrator nuk mund te përfaqesoje nje ose disa ortake te shoqërise.

16.2 Numri i votave i korrespondon pjeseve te kapitalit te zoteruara nga secili ortak.

16.3 Votat numerohen nga personi qe merr përsipër kryesimin e mbledhjes i caktuar ne fillim te cdo mbledhje dhe ato regjistrohen ne librin e Ortakeve. Kryesimi i mbledhjes merret nga administratori vetem ose nga Presidenti i Keshillit te Administrimit, dhe ne mungese te ketyre te fundit, nga me i vjetri i administratoreve, përvec nese vendoset nga votimi pro i ortakeve qe përfaqesojne shumicen e pjeseve te kapitalit te pranishem ne Asamble.

16.4 Libri i Ortakeve mbahet nga njeri prej administratoreve ose sekretari i mbledhjes i cili nenshkruan se bashku me kryesuesin e mbledhjes.

## **Neni 17 Organi i administrimit**

17.1 Asambleja e ortakeve ose Ortaku i Vetem ka te drejten te vendose nese administrimi i shoqërise do te behet nga nje administrator i vetem apo nga keshilli i administrativ i perbere nga minimumi 2 (dy) dhe maksimumi 5 (pese) administratore.

17.2 Administrimi i shoqërise i cili kosiston ne kryerjen e te gjithë veprimeve te administrimit per realizimin e objektit te veprimtarise se shoqërise, i besohet administratorit te vetem ose keshillit administrativ. Ne rastin e Keshillit administrativ secili nga administratorët eshte i detyruar te informoje keshillin per çdo veprim te kryer, dhe ne rast kundërshtish vendos Asambleja e ortakeve.

17.3 Administratori i vetem ose administratorët (nese jane emeruar) qendrojne ne detyre per 3 (tre) vjet pervec nese shkarkohen nga Asambleja e ortakeve. Kushdo qe administron shoqërine pergjigjet personalisht perballe saj dhe te treteve per shkelje te mundshme te ligjit dhe/ose statutit dhe/ose per gabimet e kryera gjate administrimit te shoqërise.

17.4 Administratorët/Administratori i vetem, do te qendrojne ne detyre per 3 (tre) vjet dhe rizgjidhen automatikisht, pervec rasteve te doreheqjes apo shkarkimit nga detyra.

17.5 Ne rastin e administrimit me Keshill Administrimi, ky zgjedh brenda tij nje President dhe nje Administrator te Deleguar.

17.6 Presidenti i Keshillit te Administrimit duhet te therrase Keshillin te pakten nje here ne dy muaj dhe te njoftoje Keshillin e Administrimit per mbarevajtjen e shoqërise. Nese ekzistojne mosmarreshje ndermjet administratoreve, Presidenti duhet te therrase Asamblene e Ortakeve, e cila mund te vendose ne lidhje me kundërshtite.

17.7 Ne rastin e Keshillit te Administrativ, administratorët mund te veprojne bashke ose vec e vec. Ne cdo rast, nese ekzistojne kundërshtime ndermjet administratoreve keta i drejtohen Asamblese se ortakeve, e cila dhe mund te zevendesoj Keshillin e administrimit e te emerjoj administratore te tjere. Administratori ose keshilli administrativ mund te shkarkohen ne cdo moment me vendim te Asamblese se ortakeve, me voten pro te ortakeve qe përfaqesojne shumicen e kapitalit te Shoqërise, pa detyrim motivimi; megjithate nese shkarkimi eshte bere pa arsye te drejte, lihet shkak per demshperblim financiar.

17.8 Ne rastin e doreheqjes se nje administratori brenda 30 (tridhete) diteve duhet te thirret Asambleja e ortakeve ose Ortaku i Vetem per emerimin e administratorit te ri, ne se ky vendim nuk merret ne te njejten mbledhje Asambleje kur eshte vendosur largimi i administratorit.



## **Neni 18 Administrimi**

18.1 Me themelimin e shoqërise emerohet administratore **Z. Jetmir Xharavina** per nje periudhe 3 vjeçare.

18.2 Administratorit i besohet administrimi i shoqërise; ne kete kuader organi administrativ mund te kryeje akte dhe veprime si te veprimtarise se zakonshme dhe te jashtezakonshme te shoqërise, me perjashtim te akteve e veprimeve qe ligji dhe ky Statut i japin veçanerisht asamblese se ortakeve.

## **Neni 19 Viti ushtrimor**

19.1 Vitet ushtrimore perputhen me vitet kalendarike, ato fillojne me 1 Janar dhe mbarojne me 31 Dhjetor te çdo viti.

19.2 Perjashtimisht viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Regjistrin Tregetar, e mbyllet me 31 Dhjetor.

## **Neni 20 Bilanci dhe Kontabiliteti**

20.1 Bilanci vjetor i Shoqërise shqyrtohet ne mbledhjet e Asamblese se ortakeve ose te Ortakut te Vetem dhe duhet te pergatitet per t'ju paraqitur organeve fiskale brenda afateve te percaktuara ne ligj.

20.2 Kontabiliteti mbahet ne gjuhe dhe monedhe shqiptare.

20.3 Kontabiliteti dhe bilanci do te paraqiten ne gjuhen shqipe.

20.4 Shoqëria mund te marre financime nga ortaket ose institucione financiare shqiptare apo nderkombetare. Per kete qellim, Shoqëria mund te ofroje garanci, hipoteke ose peng me kusht qe te jete autorizuar nga Asambleja e ortakeve ose Ortaku i Vetem.

## **Neni 21 Rezultati financiar**

21.1 Per te realizuar objektivin e veprimtarise, Shoqëria duhet te kete aftesi financiare te nevojshme.

21.2 Fitimet qe rezultojne nga mbyllja e vitit ushtrimor, pas pagimit te tatimeve dhe detyrimeve te tjera ligjore, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me pjeset e kapitalit te zoteruara.

21.3 Humbjet e Shoqërise do te mbulohen brenda kufirit te kapitalit te Shoqërise dhe çdo ortak do te pergjigjet per pjeset e tij te kapitalit

## **Neni 22 Likuidimi**

22.1 Shoqëria do te likujdohet kur te vendoset prishja e saj nga Asambleja e ortakeve.

22.2 Procedurat e likuidimit do te kryhen nga nje likuidator ose nga nje grup likuidatoresh te emeruar nga Asambleja e ortakeve ose Ortaku i Vetem.

22.3 Likuidatori do te pergatise raportin duke shqyrtuar aktivin dhe pasivin e Shoqërise, duke kryer veprimet perkatese te likuidimit brenda kohes se nevojshme per likuidimin. Ne fund te ketij procesi, Asambleja e ortakeve ose Ortaku i Vetem analizon bilancin perfundimtar dhe mbylljen e procedurave te likuidimit.

22.4 Në çdo rast respektohen dispozitat e ligjit tregtar.



**Neni 23**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

23.1 Autoriteti gjyqësor shqiptar do të kompetencë ekskluzive për zgjidhjen e të gjithë mosmarrëveshjeve ndërmjet ortakëve që nuk janë zgjidhur miqesisht.

**Neni 24**  
**Ligji i zbatueshëm**

24.1 Për sa nuk parashikohet nga ky Statut, referencë bëhet në legjislacionin e zbatimit Shqiptar në fuqi.

24.2 Ky Statut hartohet ne 3 kopje autentike në gjuhën shqipe.

Lexuar, aprovuar e nënshkruar.

**ORTAKU THEMELUES**

Tiranë, dt. 22.10.2020

Z. Jetmir Xharavina

JETMIR  
XHARAVINA

